



720 orë është totali i orëve sa ka muaji i madhërishëm i Ramazanit (kuptohet nëse muaji ka 30 ditë). Çdokush ka mundësi që t'i shfrytëzojë ato madje siç është më së miri, dhe ja ne, në vijim, u sjellim – propozojmë hapa praktik për shfrytëzim maksimal të çdo kohe të ditës së Ramazanit.

Hapi i parë: Qëllim të mirë

Qëllim – nijeti është shumë me rëndësi ngase është bazë mbi të cilën ndërtohen veprat dhe pikërisht në saje të nijetit njeriut arrin majat.

I madhëruar qoftë Allahu që na furnizon për nijetetet tona!

Ka thënë i Dërguari i Allahut, Muhammedi, alejhi's selam:

“ ?? ??? ????? ????? ? ?????? ? ??? ?? ?? ????? ?? ?????

Kush agjëron Ramazanin me besim dhe llogari (në shpërblimin e Zotit), atij do t'i falen mëkatet e kaluara.”[\[1\]](#)

Hapi i dytë: Vendosmëria për punë dhe aktivitet

Ka thënë i Dërguari i Allahut, Muhammedi, alejhi's selam:

“??? ????? ????? ????? ?????? ?????? ???? ?????? : ????? ??? ????? ?????? ??
????????????? ??? ??????

Kur njerëzit të kenë deponuar arin dhe argjendin, atëherë ju depononi këto fjalë: O Zoti im! Unë

të lus për përforsim në çështje (fe) dhe vendosmëri në të drejtën!”[2]

Hapi i tretë: Lexo ndonjë broshurë që shtjellon agjërimin, dispozitat dhe edukatën përkatëse me të, në mënyrë që të njoftohesh përgjithësisht me këtë adhurim madhështor në islam.

Hapi i katërt: Falja e pesë kohëve namaz në xhami

27 (shkallë[3]) x 5 (kohë namaz) = 135 grada ditore që mund të fitosh vetëm prej namazit. Pejgamberi, alejhi's selam ka thënë:

“???????????? ???? ????????? ???? ?????? ???? ”

Namazi me xhemat tejkalon (në shpërblim) namazin vetëm për njëzeteshtatë shkallë.”[4]

Hapi i pestë: Kur’ani Fisnik

Planifiko që gjatë çdo dite të lexosh nga dhjetë xhuza (pjesë). Si?

Të shkosh në xhami bashkë me muezzinin (në kohën kur ai e hap xhaminë) dhe pas faljes së sunnetit të lexosh një xhuz derisa të vijë koha e namazit, e pastaj, pas namazit të lexosh edhe një tjetër. Kësisoj, brenda një dite lexon 1/3 e Kur’anit.

Hapi i gjashtë: Ndërtimi i një shtëpie në Xhennet

Këtë mund ta arrijmë duke u kujdesur për faljen e sunneteve të namazeve gjatë ditës. nëse falim 2 rekate sunnet para sabahut, 4 para dhe 2 pas drekës, 2 pas akshamit dhe 2 pas jacisë (farzit), atëherë do arrijmë ndërtimin e një shtëpie të tillë. Muhammedi, alejhi's selam ka thënë:

“?? ??? ?????? ????? ????? ?? ??? ????? ? ??? ?? ??? ??? ?? ????? ”

Kush falë 12 rekate gjatë ditës dhe natës, atij do t’i ndërtohet një shtëpi në Xhennet.”[5]

Hapi i shtatë: Ushqe agjëruetit

Agjëro Ramazanin më shumë se një herë në të njëjtën kohë duke ushqyer agjëruetit ngase Muhammedit, alejhi's selam ka thënë:

“?? ??? ?????? ??? ?? ??? ????? ? ??? ??? ?????? ?? ??? ?????? ????? ”

Kush ushqen një agjëruet (i ep iftar) ai ka shpërblimin edhe të tij edhe pse këtij të fundit nuk i pakësohet fare shpërblimi.”[6]

Hapi i tetë: Haxh dhe Umre cdo ditë

Ka thënë Pejgamberi, alejhi's selam:

“?? ??? ????? ?? ????? ?? ??? ????? ????? ????? ?? ??? ?????? ????? ?? ???
??? ?????? ??? ??? ????? ?????? ?????? ????? ?????? ????? ?????

*Kush fal sabahun në xhemat pastaj ulet dhe e përkujton Allahun derisa të lind dielli, për të falë
më pas dy regate, ai ka shpërblimin sikur të ketë bërë një haxh dhe umre – dhe tha i Dërguari i
Allahut- të plotë, të plotë, të plotë!”[\[7\]](#)*

Hapi i nëntë: Lëmosha qoftë edhe me diç simbolike

Ka thënë i Dërguari i Allahut, alejhi's selam:

“????? ?????? ??? ??? ????

Frikësojuni zjarrit qoftë edhe më një gjysmë hurmeje!”[\[8\]](#)

Po kështu ka thënë i Dërguari i Allahut, alejhi's selam:

“????? ?????????? ?????????? ?????????? ??? ? ?????? ????????? ? ?????? ?? ??????????
????? ?????????????? ??? ? ?????????? ?????????? ?????????? ??????????
????????????????? ?????????????? ? ?????? ?????????????? ??? ? ?????? ??????????
????????????? ?????????????? ?????????? ?????????? ?????????? ??????????????

*Kush jep lëmoshë nga pasuria e fituar me të mirë (hallal) qoftë edhe sa një hurme, (vëni re me
të mirë) ngase Allahu nuk pranon asgjë përveç së mirës, Allahu do ta pranojë atë me të djathtën
e Tij dhe do t'ia rritë pronarit, ashtu siç ndonjëri prej jush e rrit mëzin e tij, madje derisa të (rritet
e të) bëhet sa kodra.”[\[9\]](#)*

Hapi i dhjetë: Jetës adhuresë shtoja 83 vite

Kur vinte Ramazani, Pejgamberi, alejhi's selam iu thoshte shokëve:

“????? ?????? ??? ?? ??? ???

...dhe në të është një natë, më e mirë se njëmijë muaj...”[\[10\]](#)

Hapi i njëmbëdhjetë: Mbaj lidhjet familjare

Mbaj lidhjet familjare dhe interesohu për ta çdo ditë ngase kjo të sjell jetë, pasuri dhe dashuri.
Ka thënë i Dërguari i Allahut, alejhi's selam:

“????????? ?? ?????????? ?? ?????? ?? ?????????? ??? ??? ?????? ?????? ?? ?????????????? ??
?????? ?????? ?? ??????

*Mësoni nga loza – gjenealogjia juaj atë që do t'i mbani lidhjet tuaja familjare me të, ngase
mbajtja e tyre të sjell dashuri (të ndërsjellë) në falje, shtim në pasuri dhe jetëgjatësi në gjurmë
(jetë, pasardhës).”[\[11\]](#)*

Hapi i dymbëdhjetë: Mos anashkalo 30 lutje të pranuar

Para vetes ke shansin e pranimi të (së paku) 30 lutjeve, kështu që përpilo një listë lutjesh për fe dhe dunja dhe çdo ditë para iftarit lutu për to. Ka thënë i Dërguari i Allahut, alejhi's selam:

“?? ?????? ??? ?????? ?? ??? ??? ?????? ??? ?????? : ?????? ??? ?????? ?????? ?????? ?? ??? ?? ?????? ?? – ??? ?? ?????? : ??????”

Vërtet, agjëruesi në kohën e iftarit ka (në dispozicion) lutje që nuk i refuzohet. E kam dëgjuar Abdullahun të jetë lutur në iftarin e tij: O Zoti im, të lus me mëshirën Tënde që përfshin çdo gjë që të më falësh – në një transmetim tjetër ka shtuar- mëkatet e mia!”^[12]

Burimi: <http://saaaid.net/mktarat/ramadan/501.htm>

Përshtati në shqip: Sedat ISLAMI, 2011

^[1] Hadithi është autentik. Shih: Sahihu-l-xhamii, 6325.

^[2] Hadithi ka rrugë të ndryshme transmetimi që njëra forcon tjetrën dhe kështu nuk mund të quhet i dobët.

^[3] Kaq shpërblehet namazi në xhemat në krahasim me atë në shtëpi.

^[4] Transmeton Buhariu.

^[5] Transmeton Muslimi.

[\[6\]](#) Transmeton Tirmidhiu ndërsa hadithi është hasenun sahih.

[\[7\]](#) Shih: Et-Tergib ve-t-Terhib, 1/220. hadithi ka gradën autentike, hasen apo të ngjashme.

[\[8\]](#) Transmeton Buhariu.

[\[9\]](#) Transmeton Buhariu.

[\[10\]](#) Shih: Et-Tergib ve-t-Terhib, 2/118. Hadithi ka gradën hasen.

[\[11\]](#) Hadithi ka sened xhejjid.

[\[12\]](#) Hadithi është autentik.